



Funded by  
the European Union



MODELI KOLEGIAL I SIGURIMIT TË CILËSISË NË KOSOVË

# UDHËZUES PRAKTIK PËR PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE NË KLASË

---

Projekti "Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë"



# Hyrje

Ky udhëzues është dizajnuar për të ndihmuar profesionistët arsimorë të identifikojnë praktikën jo të mirë pedagogjike dhe të japë këshilla praktike se si të përmirësohet ajo.

Këshillat në këtë udhëzues janë të bazuara në hulumtime akademike të dëshmuara. Megjithatë, meqenëse ky është një udhëzues praktik, i njëjti nuk do t'i citojë burimet akademike.

Bibliografia në fund të udhëzuesit përmban burimet akademike të cilat përforcojnë këshillat në këtë broshurë.

# Përmbajtja

Fjalorthi	3
Performancë e shquar profesionale	6
Performancë jo e kënaqshme profesionale	8
Vlerësimi	10
Informata kthyese	12
Planifikimi	15
Strategjitë e mësimdhënies	16
Menaxhimi i sjelljes	20
Bibliografia	22

# Fjalorthi

**Shënrimi mirënjohës** është kur mësimitdhënësi përdor shenjën  $\checkmark$ , shenja të thjeshta apo përmirësime (10/10), vulën dhe/ose komente të shkurta të bazuara në arritje.

**Përmbajtje e diferencuar** do të thotë përdorimi i formave të ndryshme të mësimitdhënies si video, tekste, ligjërime apo audio.

**Diferencimi përmes produktit** do të thotë që mësimitdhënësit vlerësojnë njohurinë apo shkathtësinë e njëjtë për secilin nxënës por u ofrojnë nxënësve një varg mënyrash për ta demonstruar dijen e tyre (p.sh., video, raport me shkrim).

**Diferencimi përmes procesit**, do të thotë që mësimitdhënësit ua mësojnë konceptin apo shkathtësinë e njëjtë secilit nxënës por ndryshon mënyra e mësimitdhënies. Nxënësit mund të punojnë në çifte apo grupe, mund të përdorin teknologjinë apo objekte për t'u ndihmuar në kuptimin e konceptit.

**Diferencimi i mjedisit të mësimit** do të thotë që mësimitdhënësi bën ndryshime ose në mjedisin fizik apo në ambientin në të cilin punojnë nxënësit.

**Informata kthyesë** mund të jenë në formë të shkruar ose me gojë. Është informatë të cilën mësimitdhënësi ia jep nxënësit lidhur me performancën e tij (Notimi i nxënësit, p.sh., 1, 2, 3, 4, 5 nuk është informata kthyesë)

**Vlerësimi formativ**: përdoret për të informuar procesin e mësimitdhënies dhe nxënies. Ai identifikon keqkuptimet dhe boshllëqet në nxënie dhe e përmirëson mësimitdhënies dhe nxënies. *Për shembull: kuizet, reflektimet në klasë, përdorimi i pyetjeve të hapura, sondazhe, punë në grupe me detyra më të rëndomta.*

**Vlerësimi formativ afatgjatë**: Arritja e nxënësit monitorohet përgjatë njësive mësimore. Cikli i vlerësimit mund të jetë nga 4 javë deri në 1 vit. Të dhënat përdoren për të bashkërenduar planprogramin, për të monitoruar mësimitdhënien e planprogramit dhe arritjet e nxënësve brenda një periudhe të gjatë kohore. *Për shembull: vlerësimi në fund të gjysmë vjetorit, vlerësimi në fund të vitit shkollor.*

**Vlerësimi formativ afatmesëm**: bëhet në fund të një faze të mësimit-nxënies. Ky vlerësim bëhet çdo 1 deri në 4 javë. *Për shembull: vlerësimi i një pjese të shkruar që është kulminacioni i punës trejavore. Një test në matematikë pas dy javë mësimit të thyesave.*

# Fjalorthi

**Vlerësimi formativ afatshkurtë:** një tjetër fjalë për këtë është 'mësimdhënia reaguese'. Ky vlerësim bëhet brenda dhe ndërmjet orëve mësimore. Mësimdhënësi reagon ndaj të dhënave të mbledhura dhe mësimdhënien e përshtat në përputhje me këto të dhëna. *Për shembull: pyetjet e hapura, vëzhgimi i mësimdhënësit, kuizet, dhënia individuale e përgjigjeve në tabelë të bardhë ose në letër.*

**Pyetja e hapur** është mënyrë kyçe e kontrollimit të të kuptuarit në një moment të njësisë e cila është tejet e rëndësishme që nxënësit ta kuptojnë. Çdo nxënës duhet t'i përgjigjet pyetjes brenda dy minutave. Mësimdhënësi duhet të jetë në gjendje të mbledhë dhe interpretojë përgjigjet nga të gjithë nxënësit brenda 30 sekondave dhe të vendosë se si të vazhdojë tutje më mësimin.

**Metakognicioni** ka të bëjë me mënyrat se si nxënësit monitorojnë dhe qëllimshëm drejtojnë nxënien e tyre.

**Vlerësimi nga shoku/shoqja** ndodh kur nxënësit marrin përgjegjësinë për të vlerësuar punën e shokut/shoqes së tyre kundrejt kriterëve të përcaktuar.

**Mësimdhënia reaguese:** është një mënyrë tjetër e të thënit vlerësimi formativ afatshkurtër.

**Rubrika** është një udhëzues për vlerësimin e performancës, të një produkti apo projekti. Ajo zakonisht përmban kriteret e performancës; dhe shkallën e notimit (shkëlqyeshëm, mirë, kënaqshëm, jo kënaqshëm ose 1, 2, 3, 4, 5 ose A, B, C, D, E)

5	4	3	2	1
Tregoi të kuptuar të thellë të detyrës	Tregoi të kuptuar gjithëpërfshirës të detyrës	Tregoi të kuptuar bazik të detyrës	Tregoi të kuptuar të kufizuar të detyrës	Nuk e kuptoi detyrën.

**Vetëvlerësimi:** është kur nxënësit vlerësojnë vetveten. Mund t'i vlerësojnë veprimet e tyre, qëndrimet apo performancën e tyre.

**Nxënësit e vetorganizuar:** kuptojnë dhe kontrollojnë mjedisin e tyre të nxënies.

Aftësitë e vetorganizimit përfshijnë vënien e qëllimeve, vetëmonitorimin dhe vetudhëzimin.

**Këshilli i nxënësve:** është grupi i nxënësve të zgjedhur nga moshatarët e tyre për të adresuar shqetësimet e tyre.

**Kriteret e suksesit:** është një listë e tipareve të cilat mësimitdhënësi dëshiron që nxënësit e tyre t'i përfshijnë në punën e tyre gjatë një ore mësimore.

## Performancë e shquar profesionale

	E shquar
Planifikimi	<p>Objektivat e njësisë mësimore janë të qarta dhe në lidhje me temën.</p> <p>Plani dëshmon qartë nxënien e individualizuar përmes përdorimit të aktiviteteve, diferencimit dhe strategjive të vlerësimit.</p> <p>Burimet e propozuara përshtaten qartë me objektivat e njësisë mësimore.</p> <p>Nxënësit nxiten në mënyrë të duhur.</p>
Njohuria e lëndës	<p>Njohuri e shkëlqyer e lëndës. Mësimdhënësi përshtatë njohuritë akademike për moshën dhe aftësitë e nxënësve. Mësimdhënësi lidh me shkathtësi lëndën me situata praktike të jetës reale.</p>
Sjellja dhe qëndrimi i nxënësve ndaj nxënies	<p>Nivel i lartë i angazhimit, mirësjellje dhe bashkëpunim ndërmjet të gjithë nxënësve. Ekziston një klimë produktive për nxënie në të cilën nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të sigurtë.</p>
	<p>Mësimi zhvillohet pa ndërprerje. Strategjitë e menaxhimit të sjelljes kontribuojnë të jetë një klimë e vazhdueshme pozitive për nxënie. Qëndrimi i nxënësve ndaj nxënies së tyre dhe ndaj nxënies së tjerëve është shembullore.</p>



# Performancë e shquar profesionale

	E shquar
<b>Vlerësimi formativ dhe informata kthuese</b>	Nxënia e mëparshme vlerësohet në mënyrë të saktë përmes vlerësimeve diagnostikuese siç është pyetjet me shumë zgjedhje dhe vlerësime tjera formative afatshkurta. Vlerësimet diagnostikuese përdoren në mënyrë të duhur. Mësimdhënësi reagon në mënyrë efektive në vlerësimet diagnostikuese brenda orës mësimore dhe e përshtat njësinë mësimore në përputhje me to.
<b>Strategjitë e mësimdhënies</b>	Ora mësimore përfshinë strategji imagjinate të cilat sfidojnë nxënësit. Ato nxisin të menduarit kritik dhe kreativitetin. Strategjitë e mësimdhënies individualizojnë nxënien përmes diferencimit të përmbajtjes së procesit, produktit dhe të mjedisit të nxënies.
	Të pyeturit në mënyrë sistematike nxitë të kuptuarit, identifikon keqkuptimet dhe parashikon ndërhyrjet. Reagimi i mësimdhënësit ndaj të pyeturit ka ndikim të konsiderueshëm në të nxënit e nxënësve.
	Mësimdhënësi menaxhon shkëlqyeshëm orën mësimore. Shpejtësia përdoret në mënyrë të duhur për zgjerimin e njohurive në mënyrë të duhur dhe për të sfiduar nxënësit.
<b>Përparimi i të nxënit</b>	Të gjithë nxënësit shfaqin shkallë të lartë të entuziazmit dhe interesimit. Kanë vetëbesim dhe janë të angazhuar në orën mësimore. Nxënësit udhëheqin të nxënit dhe kuptojnë hapat e radhës në procesin e të mësuarit.

## Performancë jo e kënaqshme profesionale

	Jo kënaqshëm
Planifikimi	Planifikimi dhe përgatitja është jo adekuate, e paqartë ose mungon fare.
Njohuria e lëndës	Njohuri e kufizuar e lëndës. Ose, njohuria e lëndës është jo e duhur për moshën dhe aftësitë e nxënësve. Mësimdhënësi bën gabime të shpeshta lidhur me përmbajtjen e lëndës e cila mësohet.
Sjellja dhe qëndrimi i nxënësve ndaj nxënies	Nuk ka dëshmi për të demonstruar ekzistimin e një klime pozitive e të nxënit.
Vlerësimi formativ dhe informata kthye	Vlerësimi merr pak për bazë të nxënit e mëparshëm. Nuk ka dëshmi të vlerësimit formativ diagnostikues siç është pyetjet me shumë zgjedhje brenda orës mësimore. Mësimdhënësi nuk bën asnjë përshtatje të mësimdhënies dhe të nxënit.
	Nxënësve u jepet nota 1, 2, 3, 4, 5 pa asnjë informatë kthye me shkrim apo me gojë.
	Nxënësit nuk bëjnë vetëvlerësim të punës së tyre. Atyre u jepet nota 1, 2, 3, 4, 5 pas asnjë koment.

## Performancë jo e kënaqshme profesionale

	Jo kënaqshëm
Strategjitë e mësimdhënies	Nuk ka dëshmi për objektiva apo diferencim të të nxënit. Të gjithë nxënësit bëjnë detyrën e njëjtë në të njëjtën kohë dhe shpejtësi. Aktivitetet nuk përmbushin nevojat e nxënësve individual.
	Mësimdhënia karakterizohet me pyetje të mbyllura ndaj disa nxënësve. Nuk përdoren pyetjet e vlerësimit diagnostikues/formativ.
	Orës mësimore i mungon ritmi dhe rezultatet për shkak të angazhimit të vogël të nxënësve. Nxënësit duket se bëjnë të njëjtën detyrë me ritmin e njëjtë.
	Vlerësimi merr pak për bazë të nxënit e mëparshëm. Nuk ka dëshmi të vlerësimit formativ diagnostikues siç është pyetjet me shumë zgjedhje brenda orës mësimore. Mësimdhënësi nuk bën asnjë përshtatje të mësimdhënies dhe të nxënit.
Përparimi i të nxënit	Nxënësit janë pasiv. Mësimdhënia nuk arrin të angazhojë, entuziazmojë apo motivojë nxënësit.

# Vlerësimi

## Praktikë e dobët e vlerësimit

Mësimdhënësit nuk reagojnë ndaj asaj që po ndodhë në klasë dhe nuk e përshtasin mësimdhënien e tyre.

Mësimdhënësit shpjegojnë pa përdorimin e strategjive të vlerësimit formativ afatshkurtër. Rezultat i kësaj është që mësimdhënësit prezantojnë përmbajtje e cila nuk shpjegohet në nivelin e duhur për ata nxënës.

## Sugjerime për të përmirësuar praktikën e vlerësimit

Planifiko pyetjet me zgjedhje të shumta dhe strategjitë tjera reaguese të mësimdhënies në orë mësimore.

Duke bërë këtë, njësia mësimore mund të përshtatet në kohë reale për të përmbushur më mirë nevojat e nxënësve individual.

## Praktikë e dobët e vlerësimit

Mësimdhënësit regjistrojnë të dhënat nga vlerësimi formativ por nuk reagojnë ndaj këtyre të dhënave dhe, rrjedhimisht, nuk e përshtatin njësinë ardhshme mësimore.

## Sugjerime për përmirësimin e praktikës së vlerësimit

Reago ndaj klasës.

1. Në qoftë se klasa nuk është e angazhuar, përdor një strategji të mësimi aktiv për t'i angazhuar ata. (**Mendo/Puno në çifte/Ndaj** është një strategji shumë pak e përdorur nga shumë mësimdhënës).
2. Nëse njësia mësimore është tepër e lehtë, përshtate atë.
3. Nëse njësia mësimore është tepër e vështirë, përshtate atë.
4. Sigurohu që në klasë të ketë aktivitete për të **sfiduar** ose **mbështetur** nxënësit, sipas nevoje.

## □Praktikë e dobët e vlerësimit

Mësimdhënësit nuk i ndajnë **kriteret e suksesit** me nxënës.

Mësimdhënësit nuk përdorin **rubrikat** si pjesë normale e praktikës së tyre profesionale.

Mësimdhënësit nuk kërkojnë rregullisht që nxënësit ta vetëvlerësojnë punën e tyre duke u bazuar në kritere të qarta të suksesit apo në kriteret e vlerësimit në rubrikë.

## Sugjerime për të përmirësuar praktikën e vlerësimit

Vetëvlerësimi i nxënësve duhet të jetë pjesë sistematike e praktikës profesionale.

Nxënësit duhet ta vlerësojnë rregullisht nxënien e tyre buke u banuar në kritere të qarta të suksesit.

Nxënësit duhet të vlerësojnë rregullisht detyrat dhe përparimin e tyre të përgjithshëm përmes përdorimit të rubrikave të cilat përshkruajnë qartë hapat e ardhshëm në nxënie.

# Praktikat e suksesshme të vlerësimit

Vetëvlerësimi i nxënësve është sistematik.

Nxënësit vetëvlerësojnë çdo punim të vlerësuar në fund të fazës së nxënies.  
Shembull: Test, ese, prezantim, etj.

Rubrikat mund të ndihmojnë nxënësit të vetëvlerësojnë më saktë në disa lëndë.

## E tërë puna e rëndësishme është:

1. Vetëvlerësuar
2. Vlerësuar nga shoku/shoqja
3. Vlerësuar nga mësimdhënësi

# Informata kthyese

## Praktikë e dobët e dhënies së informatës kthyese

Mësimdhënësit që vlerësojnë nxënësit me nota 1, 2, 3, 4, 5 pa asnjë informatë kthyese, me shkrim apo me gojë, se çfarë kanë bërë mirë dhe çka duhet të bëjnë nxënësit për t'u përmirësuar.

Nxënësit vlerësohen me notë në bazë të opinionit të mësimdhënësit e jo në bazë kritereve të qarta të suksesit.

Etiketimi i nxënësve në këtë mënyrë mund të jetë nënçmues dhe nuk u ndihmon atyre të identifikojnë fushat ku kanë nevojë të përmirësohen.

## Sugjerime për përmirësimin e praktikës së vlerësimit

Asnjëherë mos e vlerëso me notë nxënësin pa i dhënë një informatë kthyese.

1. Një pjesë të orës mësimore ia kushto dhënies së informatës kthyese me gojë ose me shkrim. Informata kthyese me gojë ose me shkrim duhet të identifikojë fushat ku nxënësit kanë nevojë të përmirësohen dhe cilët janë hapat e radhës në rrugëtimin e të mësuarit.
2. Përdorni rubrikat për ta bërë vlerësimin me notë më transparent ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësit.
3. Kërko që nxënësit fillimisht ta vlerësojnë punën e tyre të rëndësishme. Pastaj kërko që nxënësit ta vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. Pastaj vlerësoni punën si mësimdhënësi i tyre.

## Praktikë e dobët e dhënies së informatës kthyese

Mësimdhënësit i japin nxënësve informata kthyese për secilin gabim në punën e tyre. Kjo mund të jetë dekurajuese për nxënësit dhe largon fokusin nga qëllimet e tyre kryesore.

## Sugjerime për përmirësimin e praktikës së vlerësimit

Informata kthyese duhet të synojë fushat kyçe dhe të jetë e bazuar në kriteret e suksesit dhe/ose në qëllimet personale të nxënësit.

## Praktika e suksesshme e informatës kthyese

### Përdorimi i rubrikave

Rubrikat ndihmojnë nxënësit të:

1. Kuptojnë pritshmëritë dhe komponentët e detyrës
2. Bëhen nxënës të vetorganizuar
3. Bëhen më të ndërgjegjshëm se si mësojnë dhe si mund të përmirësohen.
4. Përmirësojnë punën e tyre përmes informatës kthyese specifike dhe të drejtuar në fusha të caktuara.

1	2	3	4	5
Tregoi të kuptuar të thellë të detyrës	Tregoi të kuptuar gjithëpërfshirës të detyrës	Tregoi të kuptuar bazik të detyrës	Tregoi të kuptuar të kufizuar të detyrës	Nuk e kuptoi detyrën.

# Planifikimi

## Praktika të dobëta të planifikimit

Mësimdhënësit nuk planifikojnë orët mësimore.

Plani i orës mësimore përshkruan njësinë mësimore por nuk përmban objektivat e nxënies apo referenca në praktika pedagogjike të dëshmuara.

## Sugjerime për përmirësimin e praktikave të planifikimit

Plani i orës mësimore **nuk ka** nevojë të jetë i detajuar por **duhet** të përfshijë:

- Objektivë të qartë të nxënies dhe kritere të suksesit.
- Një llojllojshmëri të strategjive pedagogjike (me kalimin e kohës)
- Strategji të vlerësimit formativ afatshkurtër. (P.sh. Pyetje me zgjedhje të shumta, vlerësime diagnostikuese duke përdorur tabela të bardha)
- Të nxënit e individualizuar. Orët mësimore duhet të diferencohen në bazë të përmbajtjes, procesit, produktit dhe/ose mjedisit të të nxënit.
- Sfida. Mësimdhënësit duhet të planifikojnë një sfidë në çdo orë mësimore.

## Praktika të dobëta të planifikimit

Mësimdhënësit bëjnë planifikim të tepruar. Mësimdhënësit shkruajnë plane ditore dhe javore jashtëzakonisht të detajuara. Planet nuk dëshmojnë realitetin se çka mësohet në klasë.

Planet (mund të) kopjohen nga ndonjë burim i njësisë mësimore pa asnjë përshtatje.

## Sugjerime për përmirësimin e praktikës së planifikimit

Dokumentacioni i planifikimit duhet të jetë praktik dhe i lehtë për përdorim. Nuk duhet të jetë vetëm ushtrim me një tabelë për vendosjen e shenjës tick (✓).

Realizimi i planit të orës mësimore është më i rëndësishëm se sa dokumenti fizik.

Planet e orëve mësimore nga librat e mësuesit apo nga burime tjera të planifikimit duhet të përshtaten për të përmbushur nevojat individuale të klasës. (Shënimet anash në planet e orës mësimore mund të dëshmojnë përshtatjen.)

### Praktikat e suksesshme të planifikimit

Mësimdhënësit mund të kursejnë kohë duke zhvilluar plane praktike për një periudhë më të gjatë kohore. (Për shembull: një skemë të punës që zgjatë 2 muaj)

Disa njësi mësimore mund të kërkojnë plan individual të orës mësimore por njësitë tjera mund të kenë objektiva të njëjta për disa orë mësimore.

Lesson/s (1 lesson or series of lessons)	Learning objectives /intentions	Possible Teaching and Learning Activities Activities should be adjusted based on formative assessment within lessons. Teachers must respond to the formative assessment data and adapt their lesson to meet the needs of the students.	Success Criteria (How do the students know what they have achieved? Rubrics etc.)	Assessment /Feedback Opportunities (Student self-assessment /Peer assessment/Or al teacher feedback as necessary)
1 Lesson		Starter (warm up activity- not just homework).  Activity (Range of student led and teacher led activities)  Differentiation by content, process, or learning environment  Extra Challenge for students  Learning Check (Formative assessment questions (Hinge questions)? Formative assessment strategies)		
2-5 Lessons		Starter (warm up activity- not just homework).  Activity (Range of student led and teacher led activities)  Differentiation by content, process, or learning environment  Extra Challenge for students  Learning Check (Formative assessment questions (Hinge questions)? Formative assessment strategies)		



# Strategjitë e mësimdhënies

## Strategji të dobëta të mësimdhënies

E tërë klasa bën një aktivitet ku *niveli i vështirësisë është i njëjtë për secilin nxënës.*

## Sugjerime për përmirësimin e strategjive të mësimdhënies

Përpiquni ta individualizoni të nxënit. Diferenconi orët mësimore në bazë të përmbajtjes, produktit, procesit ose mjedisit të nxënies. (Shih fjalorthin për përshkrime)

Për shembull:

Për shembull: (Diferencimi në bazë të përmbajtjes)

Mësimi i shokut/shoqes përdoret brenda orës mësimore në matematikë (Diferencimi përmes procesit)

Disa nxënës në orë të matematikës zbatojnë matematikën e tyre për të vlerësuar një problem në jetën reale. (Diferencimi në bazë të produktit)

## Strategji të dobëta të mësimdhënies

Mësimdhënësit të cilët pyesin vetëm tre apo katër nxënës në klasë të cilët e ngrenë dorën.

## Sugjerime për përmirësimin e strategjive të mësimdhënies

1. Përdorni rregullisht strategji të nxënies aktive **Mendo - puno në çifte - ndajë / Kthehu te partneri juaj**. Kjo u jep të gjithë nxënësve mundësi të përgjigjen në pyetje para se ta zgjidhni një nxënës që përgjigjen ta jap publikisht.
2. Përdor pyetje me **zgjedhje të shumta** me tërë klasën ose strategji të nxënies ndërvepruese për të vlerësuar njohuritë e tërë klasës. Kjo u jep të gjithë nxënësve mundësi të përgjigjen në ato pyetje.

## Strategji të dobëta të mësimdhënies

Mësimdhënësit ia paraqesin klasës një video apo film pa përdorimin e strategjive të nxënies aktive apo të vlerësimit formativ afatshkurtër.

Të shikuarit e videos është aktivitet pasiv.

### Sugjerime për përmirësimin e strategjive të mësimdhënies

1. Kërko që nxënësit të mbajnë shënime të cilat pastaj i krahasojnë me partnerin e tyre.
2. Mbajtja e shënimeve mozaik:Kërko që nxënësit të mbajnë shënime për pjesë të ndryshme të videos. Pastaj nxënësit bashkohen në grupe për të krijuar shënime për tërë videon.
3. Ndale videon ashtu që nxënësit ta dëgjojnë së pari vetëm zërin, pa fotografi. Pastaj lejo ta shikojnë atë edhe me fotografi.
4. Ndale videon për të shtruar pyetje por mos pyet 1 apo 2 nxënës.

Përdor strategjinë **mendo - puno në çifte - ndaj** për të përfshirë tërë klasën. Parashtro **pyetje me zgjedhje të shumta** për tërë klasën për të kontrolluar të kuptuarit.

### Strategji të dobëta të mësimdhënies

Mësimdhënësit kërkojnë që nxënësit të hulumtojnë një temë duke përdorur internetin pa asnjë udhëzim apo përgatitje.

1. Humbja e kohës së orës mësimore.
2. Nxënësit qasen në faqe të cilat janë të pa qasshme për shkak të pengesës gjuhësore (janë në gjuhë të huaj; burimet janë të paverifikueshme).
3. Ky është aktivitet pasiv.

### Strategji të dobëta të mësimdhënies

Mësimdhënësit përdorin strategji bashkëpunuese apo aktive të të nxënësve të cilat nuk lidhen me objektivat e nxënies.

### Sugjerime për përmirësimin e strategjive të mësimdhënies

Për mësimdhënësit është e rëndësishme të përdorin strategji të nxënies aktive në çdo orë mësimore. Sidoqoftë, në qoftë se strategjitë e nxënies aktive dhe bashkëpunuese nuk lidhen me një objektivë të qartë të orës mësimore, ato kanë më pak gjasa ta rrisin arritjet dhe suksesin e nxënësve.

### Sugjerime për përmirësimin e strategjive të mësimdhënies

1. Mësimdhënësit duhet të kërkojnë faqe të përshtatshme të internetit dhe t'i ndajnë ato me nxënës.
2. Aktiviteti i kërkimit duhet të ketë objektivë dhe kritere të qarta të suksesit.
3. Mësimdhënësit duhet ta ndalin aktivitetin e kërkimit në intervale për të inkurajuar reflektimin për të mësuarit dhe të bëjë vlerësimin formativ të përparimit të nxënësve.
4. Mësimdhënësit mund ta zërthejnë orën mësimore me strategji të nxënies aktive siç është **mendo - puno - në çifte - ndaj**.
5. Mësimdhënësit mund të kërkojnë që nxënësit të reflektojnë për punën e tyre në intervale të ndryshme.
6. Mësimdhënësit u japin nxënësve një rubrikë që vlerëson shkathtësitë e tyre për kërkim dhe mbajtje të shënimeve.

### Strategji të suksesshme të mësimdhënies

- Nxënësve u jepen zgjedhje kuptimplota lidhur me atë se çka dhe si mësojnë.
  - Të vetëm, në çifte, në grupe.
  - Disa nxënës nuk janë të mirë në mësim bashkëpunues dhe mund të parapëlqejnë të punon të vetëm.
- Nxënësit rregullisht bëjnë kërkime bashkëpunuese dhe ushtrime për zgjidhjen e problemeve të bazuara në kritere të qarta të suksesit.
  - Mësimdhënësi i referohet shpeshherë këtyre kritereve të suksesit për të siguruar përqendrimin në objektiven e nxënies.
- Nxënësve u jepet mundësia të regjistrojnë dhe prezantojnë të nxënit e tyre në disa mënyra.
  - Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin në kërkimin e temës së njëjtë por gjetjet e tyre i prezantojnë në mënyra të ndryshme.
- Mësimdhënësit sigurohen që strategjitë e nxënies aktive të përdoren në çdo orë mësimore.

Këto strategji të nxënies aktive janë të lidhura me objektiva të qarta të orës mësimore.

*(Ato nuk përdoren thjeshtë për të plotësuar kohën e orës mësimore apo për të lënë përshtypje te vëzhguesit e orës mësimore)*

Mësimdhënësi duhet ta ndajë objektiven e orës mësimore me nxënësit dhe, po qe e mundur, duhet të shpjegojnë po ashtupërse po e përdorin at strategji të caktuar të mësimdhënies.

*Për shembull:*

*Ju po punoni në grupe sepse...*

*Qëllimi i kuizit është t'ju mësojë ....*

*Qëllimi i këtij aktiviteti në role është...*

*Dua që vet ta vlerësoni punën tuaj në mënyrë që të ...*

# Strategji të nxënies aktive

## Mendo - Puno në çifte - ndajë / Kthehu te partneri yt

Mësimdhënësi i parashton grupit një pyetje dhe secili nxënës ka një apo dy minuta të mendojë për pyetjen. Pastaj, ata kthehen dhe diskutojnë me dikë që është ulur pranë tyre para se ta ndajnë atë me tërë klasën.

### Procedura e "pushimit"

Kur mësimdhënësit ligjërojnë, shfaqin video, paraqesin informata, ata duhet të 'pushojnë' dy deri në pesë minuta.

Gjatë këtij pushimi, i inkurajojnë nxënësit t'i ndajnë shënimet e tyre në çifte. Mësimdhënësit u japin mundësi nxënësve të bisedojnë për atë se çfarë mësuat.

Mësimdhënësit lejojnë nxënësit që t'i përpunojnë shënimet e tyre apo të diskutojnë çfarëdo pyetje që kanë.

### Tutorimi i shokut/shoqes

Tutorimi i shokut/shoqes përfshinë një varg qasjes në të cilat nxënësit punojnë në çifte apo në grupe të vogla për t'i ofruar njëri-tjetrit përkrahje në nxënie.

Tutorimi një-drejtimësh është tutorimi i aftësive të ndërsjella përmes së cilës një nxënës merr rolin e tutorit dhe vendoset në grup me një apo më shumë nxënës, të cilët zakonisht janë më të ri në moshë.

Tutorimi reciprok, në të cilin i ndërrojnë rolet tutori dhe nxënësit.

Nxënësit marrin përgjegjësi për aspektet e mësimdhënies dhe për vlerësimin e suksesit të tyre.

### Ndarja në grupe

E ngjashme me **mendo -puno në çifte-ndaj**, por nxënësit janë në grupe prej katër nxënësve. Ata diskutojnë me dikë që është ulur pranë tyre para se ta ndajnë atë me tërë klasën.

### Luajtja e roleve

Nxënësit marrin role të cilat edhe i luajnë.

Ky aktivitet diferencon nxënies në bazë të procesit.

Ky aktivitet i mundëson nxënësve me më pak vetëbesim të shprehen lirshëm meqenëse pretendojnë se janë dikush tjetër.

### Nxënia e bazuar në probleme

Nxënësit angazhohen ta zgjidhin një situatë problematike.

Problemi duhet të jetë pjesë e botës së tyre dhe të jetë autentike për ta.

Në fillim, nxënësit identifikojnë një skenar problematik.

Pastaj nxënësit kërkojnë të gjejnë një zgjidhje.

Nxënësit prezantojnë zgjidhjen e tyre.

Pastaj nxënësit vlerësohen dhe reflektojnë për vlerësimin e tyre.

### Aktivitete të vetëvlerësimit

Nxënësit duhet të mësohen ta vetëvlerësojnë tërë punën e tyre në bazë të kritereve të qarta para se të vlerësohen nga mësuesi.

Ekzistojnë dëshmi të bollshme se të mësuarit e strategjive vetorganizuese ka ndikim të konsiderueshëm në rezultatet e nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve me një notë (1, 2, 3, 4, 5), pa e mundësuar procesin e vetëvlerësimit dhe vënies së qëllimeve, është praktikë e dobët pedagogjike.

### Metoda jigsaw

Jigsaw është strategji e nxënies në bashkëpunim e cila mundëson që secili nxënës në grupin 'shtëpi' të specializojë në një aspekt të temës.

Nxënësit takohen me anëtarë të grupeve tjera të cilëve u është caktuar tema e njëjtë.

Pasi ta kenë mësuar atë temë, kthehen në grupet 'shtëpi' dhe ua mësojnë atë material pjesëtarëve të grupit.

# Menaxhimi i sjelljes

## Praktikë e dobët e menaxhimit të sjelljes

Nxënësit kanë sjellje të këqija. U mungon entuziazmi për orë mësimore.

Shumica e nxënësve nuk angazhohen.

Mësimdhënësit menaxhojnë klasën me përforsim negativ.

Nxënës individual etiketohen dhe marrin vetëm përforsim negativ.

## Sugjerime për përmirësimin e praktikës së menaxhimit të sjelljes

Përdor strategji të mësimdhënies ndërvepruese për të përshtatur mësimdhënien dhe nxënies që t'i përmbush më mirë nevojat e nxënësit.

Përdor më shumë strategji të nxënies me nxënësin në qendër. Nxënësve u jepni më shumë zgjidhje për nxënie.

Përdor strategji pozitive të menaxhimit të sjelljes.

## Strategji të suksesshme të menaxhimit të sjelljes

Lavdërimi specifik i sjelljes

Lavdërimi specifik i sjelljes përfshinë referim të qartë për sjelljen e dëshiruar.

Është specifike për individin dhe formulohet në mënyrë pozitive.

Për shembull, mësimdhënësi i cili pohon aftësinë e një nxënësi për të punuar pavarësisht shpërqendrimeve nga të tjerët, mund të bëjë komentin pohues në vijim:

*"Shumë mirë, Valbona, që po qëndron plotësisht e përqendruar në punën tënde "*

## Sinjalet e heshtura (gjestet me dorë, etj.)

Mësoni nxënësit të reagojnë ndaj sinjaleve të heshtura, siç janë gjestet me dorë dhe shprehjet e fytyrës.

## Korrigjimet me zë të ulët (jo korrigjime publike)

Përpiqui të mos i korrigjoni nxënësit publikisht. Kurseni ata nga turpërimi duke i korrigjuar në mënyrë më personale.

### Sinjalizimi i sjelljes së pritshme

Para se të fillojë aktiviteti, ua rikujtoni nxënësve se çfarë sjellje pritet nga ta. Kjo është posaçërisht e rëndësishme nëse ata fillojnë me një aktivitet të cilin nuk e kanë bërë më përpara ose nëse janë në një mjedis të ri.

### Krijoni rutina të qarta

Rutina ndihmon nxënësit të ndihen të sigurtë. Është praktikë e mirë të krijohen rutina për kohën kur nxënësit hynë në klasë dhe kur e përfundojnë punën ashtu që të mos humbë koha e orës mësimore.

### Veçoni momentet kur nxënësit sillen mirë

Kur nxënësit janë në rrezik të gjenden në një spirale të sjelljes negative, inkurajoni tërë personelin e shkollës që të shohin mundësitë për ta lavdëruar nxënësin kur ai/ajo bën ndonjë gjë pozitive.

# Bibliography

**Centre for Teaching Excellence. (2019).** Rubrics: Useful Assessment Tools | Centre for Teaching Excellence. [online] Available at: <https://uwaterloo.ca/centre-for-teaching-excellence/teaching-resources/teaching-tips/assessing-student-work/grading-and-feedback/rubrics-useful-assessment-tools>.

**Cornell University (2019).** Using Rubrics | Center for Teaching Innovation. [online] Cornell.edu. Available at: <https://teaching.cornell.edu/teaching-resources/assessment-evaluation/using-rubrics>.

**Education Endowment Foundation (n.d.).** Teaching and Learning Toolkit. [online] EEF. Available at: <https://educationendowmentfoundation.org.uk/education-evidence/teaching-learning-toolkit>.

**EEF. (n.d.).** Written marking. [online] Available at: <https://educationendowmentfoundation.org.uk/education-evidence/evidence-reviews/written-marking>.

**Education Endowment Foundation (2021).** Feedback. [online] EEF. Available at: <https://educationendowmentfoundation.org.uk/education-evidence/teaching-learning-toolkit/feedback>.

**Effective classroom observation in primary and secondary schools. (2014).** [online] Available at: <https://www.estyn.gov.wales/system/files/2020-07/Effective%20classroom%20observation%20in%20primary%20and%20secondary%20schools%20-%20October%202014.pdf> [Accessed 27 Jun. 2022].

**Hattie, J. (2010).** Visible learning for teachers: Maximizing impact on learning. Routledge, Milton Park, UK.



Ho, A. and Kane, T. (n.d.). The Reliability of Classroom Observations by School Personnel. [online] Available at: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED540957.pdf> [Accessed 27 Jun. 2022].

Prince, M. (2004). Does Active Learning Work? A Review of the Research. *Journal of Engineering Education*, 93, 223-231

Tomlinson, C. A. (2014) *The Differentiated Classroom: Responding to the Needs of All Learners*, 2nd Edition

William, D; Thompson, M; (2008) *Integrating Assessment with Learning: What Will It Take to Make It Work?* In: Dwyer, CA, (ed.)

*The Future of Assessment: Shaping Teaching and Learning.* (pp. 53-82).  
Routledge: New York, NY, USA

William, D (2011) *Embedded Formative Assessment.* Solution Tree Press

William, D. and Leahy, S. (2015). *Embedding formative assessment: practical techniques for K-12 classrooms.* West Palm Beach, Florida: Learning Sciences.

[www.sec-ed.co.uk](https://www.sec-ed.co.uk). (n.d.). Teaching practice: Hinge questions. [online] Available at: <https://www.sec-ed.co.uk/best-practice/teaching-practice-hinge-questions>.



Kosovo Legal  
Services Company



IBE



EDUCATIONAL  
RESEARCH  
INSTITUTE

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Projektit KosEd dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.